



Datë: 05.03.2026  
Numër Protokolli: 1158/2026

A.nr.2024/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë të shqyrtimit të ankesës me numër A.nr.2024/2025, të datës 15.12.2025, të parashtruar nga ankuesi R.D, kundër organit të punësimit: Agjencia e Regjistrimit Civil/MPB, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.03.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprobuhet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.2024/2025, e datës 15.12.2025, e parashtruar nga ankuesi R.D.

**II. Anulohet** Njoftimi përfundimtar i datës 11.12.2025 me nr.prot.2289/01 i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për përfundimin e procedurës së rekrutimit me numër Reference RN00018595, për pozitën e punës “*Asistent i Shpërndarjes së Dokumenteve Personale në Prishtinë/MPB*” dhe çështja kthehet në fazën e verifikimit paraprak tek NJMBNJ.

**III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me zbatimin e vendimit si në pikën II të këtij Vendimi.

## A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, R.D (*më tej referuar vetëm* Ankuesi), me datë 15.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit përfundimtar të NJMBNJ të MPB-së, të datës 11.12.2025, lidhur me procedurën e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00018595 për pozitën “*Asistent i Shpërndarjes së Dokumenteve Personale në Prishtinë/MPB*”, me pretendimet ankimore se gjatë mbajtjes së testimit me shkrim me datë 1ë.11.2025, gjatë mbajtjes së testimit me shkrim, kam vërejtur një shkelje të rëndë të rregullave të

testimit, dy persona nga komisioni mbikëqyrës, të pranishëm në sallë i kanë komunikuar një kandidati të caktuar përgjigjet gjatë testit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek MPB, ndërsa kjo e fundit me datë 05.01.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 7864/2025 të datës 15.12.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 05.01.2025; Konkursin e datës 12.0ë.2025 RN000185ë5; Vendimin Nr.74/2025 datë 11.11.2025; Listën e kandidatëve të aprovuar; Njoftimin nga NJMBNJ të datës 27.11.2025 për verifikimin e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për vazhdim tutje; Testimin me shkrim të ankuesit dhe të kandidatëve fitues; Njoftimin e datës 25.11.2025 të NJMBNJ për kandidatët që kanë kaluar testimin me shkrim; Njoftimin e datës 11.12.2025 të NJMBNJ për kandidatët e sukshesëshëm në konkursin RN00018595.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pabazuar, **sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rezulton se MPB, më datë 12.09.2025 ka shpallur konkursin me Reference: RN00018595, për grupin e administrimit të përgjithshëm- arsim i mesëm, pozita e punës “Asistent i Shpërndarjes së Dokumenteve Personale në Prishtinë/MPB” numri i pozitave të kërkuara 3 pozita, klasa profesional 3, në Sektorin e Shërbimeve të Përbashkëta-ARC/MPB, ku afati për aplikim ka qenë nga data 13.09.2025 deri më 12.10.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar 248 kandidatë, ndërsa sipas Njoftimit me numër protokolli 1990/5, të datës 27.10.2025, të NJMBNJ në MPB, verifikimin paraprak e kanë kaluar gjithsej 178 kandidatë, edhe ankuesi e ka kaluar verifikimin paraprak dhe është ftuar në testim me shkrim.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore Kolegji i Këshillit ka analizuar shpalljen konkursit publik me Nr. Reference RN000185595, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm-Arsim i mesëm, pozita “Asistent i Shpërndarjes së Dokumenteve Personale në Prishtinë/MPB”, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e**

*shkollës së mesme apo ekuivalente me të. **Përvoja e punës e kërkuara: Nuk kërkohet; Kërkesa specifike: Nuk ka**, e për rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesat e përgjithshme formale të konkursit janë në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit, ka vlerësuar edhe Vendimin për themelimin e Komisionit Profesional për Pranim në shërbimin Civil dhe ka konstatuar se sipas vendimit nr.74/2025 të datës 11.11.2025 anëtar të komisionit janë:

E.H, Udhëheqës i Divizionit të Transportit, MPB, kryesues, zëvendësues R.G, Udhëheqës i QPD Prishtinë.ARC Shef i Sektorit për Prodhimin e dokumenteve, ARC/MPB; F.B, Shef i Sektorit për Prodhimin e dokumenteve, ARC/MPB, anëtar, zëvendësues A.V, Udhëheqëse e QPD Mitrovicë, ARC/MPB; P.G, Administrator në DPD/ARC anëtar, zëvendësues, F.K, Udhëheqës i Qendrës për Regjistrim të Automjeteve në Oboliq/ARC; B.S, Zyrtare e lartë e personelit në NMBNJ/MPB, anëtare, zëvendësuese B.Sh Zyrtare e Lartë e Personelit në NJMBNJ/MPB dhe F.R, u.d Udhëheqës Sektori i DPD/ARC, zëvendësues, F.K, Zyrtar për regjistrimin civil në QDP Prishtinë/ARC.

Ndërlidhur më përbërjen e Komisionit dhe nënshkrimin formularëve të vlerësimit Kolegji ju referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik respektivisht neni 40 Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë profesionale 1. Vlerësimi profesional i kandidatëve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale, andaj meqenëse në formularët e intervistimit verbal është nënshkruar F.K-Udhëheqëse e Qendrës për Regjistrim të Automjeteve në Oboliq, Kolegji konstaton se në komisionin e pranimit kanë marrë pjesë katër nëpunës të nivelit të ultë drejtues e që është në kundërshtim me dispozitën e lartshënuar.

Gjithashtu Kolegji ka analizuar edhe dosjet e kandidatëve fitues V.Xh, M.Y dhe M.Sh dhe ka konstatuar se kandidati V.Xh ka bashkëngjitur në dosjen e aplikimit Dëftesën për kryerjen e shkollës së mesme të ultë nr. prot 128/33 dhe diplomën për kryerjen e studimeve në Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi nr.8ë8/45-64 e që është në kundërshtim me kushtet formale të konkursit, sepse tek arsimi është kërkuar diploma mbi kryerjen e shkollës së mesme e që sipas shkresave të lëndës e njëjta nuk është e bashkëngjitur e që është në kundërshtim me ligin Nr.08/L-197, për Zyrtarët Publikë gjegjësisht nenit ku përcaktohet se "Nenit ë paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin,*

***përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”.***

Ngase u tha me lartë, Kolegji me qëllim të kthimit të ligjshmërisë dhe meqenëse se konkursi RN00018595 e shpalljes ka qenë në harmoni me dispozitat ligjore, u vendos që konkursi të mbetet në fuqi, por çështja të kthehet në fazën e verifikimit paraprak në NJMBNJ ngase është konstatuar se në fazën e verifikimit paraprak ka pasur lëshime tek shqyrtimi i dokumentacionit nga ana NJMBNJ, gjithashtu në Komisionin e Pranimit duhet të formohet në pajtim me nenin 40 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë se janë evidentuar shkeljeje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me Nr. Reference: RN00018595, nuk është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil, kështu që në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

***Këshillë juridike:*** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

### **Lënda A.nr.2024/2025**

**Rushit Kajtazi**

**Eshref Shabani**

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

### **Vendimi i dorëzohet:**

*-Ankueses R.D;*

*-Udhëheqësit së Divizionit të Burimeve Njerëzore në MPB; dhe*

*-Arkivit të KPMSHCK-së.*